



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 924/2 Prot.

Tiranë, më 30.06.2021

V E N D I M

Nr. 120, Datë 30.06.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 114, datë 16.06.2021, të paraqitur nga A.H dhe N.P¹ kundër E.H² dhe M.R³, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë⁴”, “gjendjes arsimore⁵”, “përkatësisë prindërore⁶” dhe “aftësisë së kufizuar⁷”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues në mes të tjerash, informon se: “*Është nënë e dy fëmijëve në proces për zgjidhje martese për shkak të dhunës fizike dhe psikologjike nga ish-bashkëshorti. Për këtë ka kërkuar ndihmë në polici, gjykatë, bashki dhe tek Avokati i Popullit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendimin nr. 51-2021-2267, datë 15.04.2021*

¹ Nëna e ankueses.

² Ish-bashkëshorti i ankueses.

³ Av. M.R është përfaqësuese me prokurë, në çështjen e zgjidhjes së martesës së E.H.

⁴ Është dhunuar psikologjikisht dhe fizikisht, si nënë dhe si grua.

⁵ Ankuesja ka arsim të lartë.

⁶ I është mohuar prindërimi për shkak të aftësisë së kufizuar të prindërvë të ankueses.

⁷ Referuar librezës së lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës të Shqipërisë, N.P është invalide e plotë.

ka vendosur zgjidhjen e martesës, dhe vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër. Çështja ka kaluar në procedim penal për dhunë në familje dhe kanosje dhe rasti po ndiqet nga Bashkia Shkodër dhe organizata “Dimension Human” dhe “Gruaja tek Gruaja” Shkodër. Ankuesja informon se diskriminohet, pasi si grua dhe si nënë duhet të heshtë, të durojë dhe të dhunohet dhe jo të rrisë në qetësi fëmijët e saj. Të qëndrojë me një burrë që ka marrëdhënie prej kohësh me një grua tjetër. Ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të formimit arsimor, pasi ka kryer studimet e larta për gjuhë të huaj angleze. Ankuesja informon se, në një nga pretendimet e ankimit të palës tjetër citohet që të jetë shprehur për “diferenca në formimin e tyre arsimor”, në fakt është shprehur “diferenca në formim dhe formimi i ndryshëm familjar”. Me këtë logjikë zhvlerësohet profesionalisht dhe intelektualisht sikur të studiosh duhet ndëshkuar. Është tentuar të privohet nga e drejta e prindërit prej ish-bashkëshortit dhe familjes së tij duke e kërcënuar me mesazhe se do e heqin nga puna dhe do i marrin fëmijët nëse ndahet. Ankesja deklaron se prindërit e saj po diskriminohen për aftësinë e kufizuar, pasi konsiderohen nga ish-bashkëshorti dhe përfaqësuesja e tij, si invalidë dhe të dëmshëm për të qëndruar me fëmijët e saj, ndërkohë që ish-bashkëshorti është i alkolizuar, i dhunshëm dhe epileptik”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të merren masa që ajo të mos diskriminohet, të fyhet, përpala asnjë institucioni, gjykate, prokurori, polici, etj, dhe rrëzimin e ankimit të palës tjetër përpala gjykatës si të pabazuar në prova dhe fakte.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzënине, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Bazuar në nenin 3/1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njoitura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 33/3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kritereve formale të një ankesë, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskrimimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44/2, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përbushjen e kritereve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërmë b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “*Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme: b) legitimimin e palës që ka paraqitur kërkesën përfillimin e procedurës administrative*”.

Neni 7 i LMD-së⁸, në pikën 1 të tij, parashikon se: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza përmohimin e barazisë ndaj një personi apo grupei personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjtë ose të ngashme, në krahasim me persona të tjera ose grupe të tjera të personash, përbën diskriminim*”.

Për të vlerësuar legitimitetin e palës kundër të cilit drejtohet ankesa, Komisioneri do i referohet parashikimeve të bëra në nenet 24, 25 dhe 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kështu, në këtë kod përcaktohet përbajtja e personit juridik: “*24. Personat juridikë janë publikë dhe privatë. 25. Personat juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen. 26. Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji*”.

Referuar parashikimeve të mësipërme, vlerësohet se “sektori publik” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore, ndërsa “sektori privat” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimit të nenit 26, të Kodit Civil.

Bazuar në dispozitat e mësipërme dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, rezulton se E.H, dhe përrjedhojë dhe përfaqësuesja e tij ligjore, nuk legitimohen si subjekte kundër të cilëve mund të paraqitet ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁸ Shkurtësë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33/4, gërmë “b”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 44, pika 2, nenin 65, gërmë b) të Ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b dhe 10 të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 114, datë 16.06.2021, të paraqitur nga shtetaset, A.H dhe N.P.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA